

**AKTI I THEMELIMIT**  
**DHE**  
**STATUTI**  
**I SHOQERISE TREGTARE**  
**“PETRA TRADING” SH.P.K TIRANE**

**Neni 1**

Ne baze ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar si dhe te ligjit nr 9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Bisnesit ” i ndryshuar , me vullnetin e tij te lire ortaku i vetem i shoqerise ka rene dakord te hartoje kete akt themelimi dhe statut te shoqerise me perjegjesi te kufizuar (sh.p.k ) “PETRA TRADING ” Sh.p.k Tirane, e cila do te veproje sipas legjisacionit ne fuqi e themeluar nga ortaku i vetem i saj si vijon:

1. **Individ z. Angelo Sciortino** me shtetesi Italiane dhe kombesi Italiane lindur me 09 Tetor 1958 ne Palermo (PA) Itali , me banim ne Itali , ne adresen : Via Dei Tigli 56p.I CERIGNOLA (FG) Italia , i identifikuar me karte identiteti italiane nr AY1739497 me date skadence 09 Tetor 2027 , madhor dhe me aftesi te plote juridike per te vepruar ligjerisht.

Deklaron se sot me date 17.01.2018, ka nenshkruar kete akt themelimi dhe kete statut dhe ka rene dakord per krijimin e nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar ne baze te ketij akt themelimi dhe statuti duke respektuar kerkesat e legjisacionit shqiptar per shoqerite tregtare.

**Neni 2**  
**EMERTIMI DHE FORMA E SHOQERISE**

Emertimi i shoqerise tregtare te themeluar nga ortaket e saj do te jetë  
**“PETRA TRADING” Sh.p.k.** Forma e shoqerise tregtare te themeluar do te jetë **shoqli me perjegjesi te kufizuar (sh.p.k)**.



A handwritten signature in blue ink, appearing to be a stylized 'A' or similar character.

### Neni 3

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Objekti i veprimtarise ekonomike te shoqerise do te jete si vijon :

- Te beje perfaqsim tregtare , ne baze te se ciles perfaqsuesi ka detyrimin ligjor te firmose dhe te lidh kontrata me shoqeri te ndryshme tregtare , cdo kontrate qiraje per depozitimin e mallit te cdo lloji karburanti ne depozitat doganore te zones se lire doganore e te beje te gjitha procedurat e nevojshme te parashikuara nga ligji ne zonen lire te doganes ne Shqiperi per llogari dhe ne emer te shoqerise porositese ne perputhje me detyrimet dhe kompetencat te percaktuara nga porositesi.
- Te beje perfaqsim tregtare , ne baze te se ciles perfaqsuesi ka detyrimin ligjor te firmose dhe te lidh kontrata me shoqeri te ndryshme tregtare , **cdo tip kontrate shitjeje e blerje** per depozitimin e mallit te cdo lloji karburanti qe rezulton i deposituar ne depozitat doganore te zones se lire doganore ne Shqiperi , per llogari dhe ne emer te shoqerise porositese ne perputhje me detyrimet dhe kompetencat te percaktuara nga porositesi.
- Te beje perfaqsim tregtare , ne baze te se ciles perfaqsuesi ka detyrimin ligjor te firmose dhe te lidh kontrata me shoqeri te ndryshme tregtare , **cdo tip kontrate shitjeje e blerje** te mallit, te cdo lloji karburanti direkt nga anija ne det dhe ne udhetim ose ne portet Shqiptare , per llogari dhe ne emer te shoqerise porositese ne perputhje me detyrimet dhe kompetencat te percaktuara nga porositesi
- Ne cilisine e perfaqsuesit , ne pershpejtimin e praktikave doganore , te beje praktikat e depozitimit te karburantit , mbikqyrje ose veprime te tjera dhe praktikat doganore qe te mundeson realizimin e procedurave doganore dhe kryerjen e formaliteteve administrative e llore ne lidhje me importimin, eksportimin dhe trazitim e mallrave ne perputhje me detyrimet dhe kompetencat te percaktuara nga porositesi
- Perfaqsim tregtar duhet te zhvilloje nje aktivitet qe pergatit dhe lehteson konkludimin e nje kontrate biznesi , duke e shoqueruar me trajtimet dhe ekzekutimin e kontrates per llogari te porositesit

- Perfaqesuesi tregtar ka te drejte per shperblim finanziar dhe duhet te marre rimbursimin finanziar te te gjitha shpenzimeve te kryera ne proceduren e praktikes doganore e te gjitha shpenzimeve te tjera te lidhura me kontraten e qirase , kontraten e shitjes , kontraten e blerjes etj dhe qe jane paguar nga llogaria e perfaqesuesit per llogari te shoqerise porositese
- Blerja , shitja, kembimi, huaja, importimi dhe eksportimi, transporti, shperndarja dhe tregtimi i te gjitha produktave , ndermjet te cilave karburant bruto , produkte karburanti gaz natyral, elektricitet , karbon, produkte kimike, grure, vajra shtazore dhe bimore, biokarburant , gjithashtu dhe magazinim.
- Transporti dhe shperndarja e produktave te tilla dhe materialeve te para , keshtu si te gjithe operacionet me instrumentat financiar apo me kontratat perkatese te produktave te tilla dhe lendeve te para , te gjitha aktivitetet dhe sherbimet e lidhura , mund te kryej dhenien e sherbimeve plotesuese dhe ato te lidhura si qera , qera anijesh , autoveturash e automjetesh , kalim pronesie e anijeve , administrim i anijeve dhe aktivitetave te lidhura
- Depozitimi , ambalazhimi dhe trajtimi i te gjitha produktave ne fushen e energjise dhe te lendeve te para , siguracione , inspeksione dhe te tjera, blerje , lenie peng, administrim, te administroje dhe shese pasuri te paluajtshme per llogari te vet ne Shqiperi dhe jashte , gjithashtu te marre pjesa ne shoqeri dhe ndermarrje industriale, imobiliare,tregetare , finanziare dhe shperbime me seline ose aktivitetin ne Shqiperi dhe jashte , ne perputhje me normat ne fuqi
- Te marre direkt apo indirekt interesa dhe pjesemarrje ne shoqeri te tjera dhe ndermarrje industriale , tregtare, finanziare dhe sherbime ne Shqiperi ose jashte , ne sektorin qe i perket objektit shoqeror dhe ne sektor te tjere , te hape filiale ndihmese jashte shtetit
- Aktivitet ndermjetesimi tregtar, industrial e finanziar, per te finalizuar dhe favorizuar ndermjet paleve konkludimin e kontratave te biznesit
- Te kryeje te gjitha operacionet tregtare, industriale e finanziare te konsideruara te nevojshme dhe te vlefshme te lidhura ne menyre funksionale me objektin apo akte per te arritur qellimin

#### **Neni 4**

#### **SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria tregetare “**PETRA TRADING** ” sh.p.k Tirane do ta kete seline saj ne Tirane , ne adresen: Bulevardi “ Bajram Curri” prane qendres se bisnesit European Trade Center (ETC ), kati 12. Ajo mund te krijoje ose te mbylle ne Shqiperi ose jashte saj, filiale, perfaqesi apo seli te tjera.

#### **Neni 5**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte 30 vjet. Si dite e fillimit te aktivitetit te saj do te merret data e regjistrimit prane Qendres Kombetare te Bisnesit . Ortaket e shoqerise kane te drejte ta zgjasin kete afat .

#### **Neni 6**

#### **KAPITALI I THEMELTAR I SHOQERISE**

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise eshte 2 679 400 leke, cili perbehet nga kontributi vetem ne para. Ky kapital i cili perbehet nga 1 ( nje) pjese (kuote) eshte nenshkruar nga ortaku i saj themelues dhe vlera nominale e nje pjese (kuote) eshte 2 679 400 (dy million e gjashteqind e shtatedhjete e nente mijë e katerqind) leke. Pjesemarrja e ortakeve ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete si vijon :

- **Ortaku , individi z. Angelo Sciortino** do te zoteroj 100 % te kapitalit te shoqerise e barabarte me 1(nje) kuote dhe vlera noninale e nje pjese ( kuote) do te jete 2 679 400 (dy million e gjashteqind e shtatedhjete e nente mijë e katerqind) leke.

#### **Neni 7**

#### **KONTRIBUTET**

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga persona fizike ose juridike, te cilet nuk perqigjen per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulojne personalisht

humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Kapitali i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ndahet ne nje numer kuotash, ne raport me kontributin dhene nga çdo ortak ne shoqeri. Çdo ortak zoteron nje kuote te vetme ne shoqeri. Bashkezoteruesit e nje kuote gezojne cilesine si nje ortak i vetem. Shoqerite me pergjegjesi te kufizuara nuk mund te ofrojne kuotat e tyre si mjete investimi per publikun e gjere.


Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta). Ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar i vleresojne kontributet ne natyre ne marreveshje te ndersjella me njeri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre ne para. Nese nuk mund te arrihet nje marreveshje, secili prej ortakeve mund t'i drejtohet gjykates perkatese, per te ngarkuar nje ekspert vleresues, me nje vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakeve ose i ekspertit per vleresimin e kontributeve i dorezohet Qendres Kombetare te Bisnesit, se bashku me te dhenat e tjera te kerkuara per regjistrim.

## Neni 8

### KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE

Kuota e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar mund te zoterohet nga nje ose me shume persona. Ne rastin kur nje kuote e kapitalit te shoqerise zoterohet nga me shume se nje person, ne marredhenie me shoqerine keta persona trajtohen si nje ortak dhe te drejtat e tyre ushtrohen, nepermjet nje perfaqesuesi te perbashket. Keta persona pergjigjen personalisht dhe ne menyre solidare per detyrimet qe lindin nga zoterimi i kuotes. Personat qe zoterojnë nje kuote te kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, merren vesh ndermjet tyre per ndarjen e te drejtave e te detyrimeve, qe rrjedhin nga kjo kuote. Keto te drejta e detyrime mund te ndahen ne menyre te barabarte ose jo. Veprimet e shoqerise ndaj kuotes se zoteruar nga me shume se nje person krijojne pasoja ndaj te gjithe zoteruesve te saj edhe nese veprimi i shoqerise i drejtohet vetem njerit prej zoteruesve. Shoqeria tregtare mund te leshoje nje certifikate per te vertetuar zoterimin e kuotes se kapitalit. Kjo certifikate leshohet ne emer te personit apo te personave, qe zoterojnë kuoten dhe nuk perben leter me vlere. Nese personat qe zoterojnë nje kuote nuk arrijne nje marreveshje atehere zbatohen dispozitat e Kodit Civil per bashkepronesine.

## Neni 9



5

## **MENYRA E FITIMIT DHE E KALIMIT TE KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata.

Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteteteve te ndryshme me efekt deklarativ, perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.

Ne rast kalimi te kuotave per persona te trete qe jane jashte shoqerise, ortaku qe shet kuotat duhet te njoftoje me shkrim shoqerine dhe duhet te ofroje te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo ortakeve te tjere te shoqerise.


Ne rast se shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit ortaket brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi duhet te blejne apo te lejojne blerjen e kuotave te kapitalit themeltar me vleren kontabile te kapitalve te veta qe do te rezultoje sipas bilancit kontabel ne daten e shitjes se kuotave.

### **Neni 10**

## **PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE**

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate perjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit.

Shoqeria regjistron kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit. Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.



## **Neni 11**

### **PJESETIMI I KUOTAVE DHE TRANSFERIMI I TYRE**

Kuotat mund te pjesetohen per shkak te kalimit te tyre. Dispozitat e nenit 73 te ligjit ‘Per shoqerite tregtare’ per kalimin e kuotave zbatohen edhe per kalimin e pjeseve te kuotave.

## **Neni 12**

### **SHPERNDARJA E FITIMEVE**

Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, ortaket kane te drejte te ndajne pjesen e fitimit te dekluaruar ne pasqyrat financiare te shoqerise. Fitimi u shperndahet ortakeve ne raport me kuotat e zoteruara.

Ortaket e shoqerise qe aprovojne shperndarjen e fitimeve (dividendit) mund te ndryshojne shperndarjen e fitimeve nga sa eshte parashikuar ne statut vetem ne se miratohet me unanimitet te plete te ortakeve duke e kaluar ate per zmadhim kapitali dhe per investime ne shoqeri.

## **Neni 13**

### **KUFIZIMET E SHPERNDARJEVE, CERTIFIKATA E AFTESESE PAGUESE**

1. Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit :
  - a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
  - b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim.
2. Administratoret leshojne nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividenteve permbush kerkesat e pikes 1 te ketij neni, ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kriteri, administratoret nuk mund ta leshojne kete certifikate.
3. Kerkesat e pikave 1 dhe 2 , te ketij neni, zbatohen gjithashtu ne rastet kur, pavaresisht nga dhenia e miratimeve te nevojshme, sipas nenit 13, te ligjit “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, shoqeria do te kryeje nje pagese ne favor te nje prej ortakeve te saj, ne baze te nje marreveshjeje te lidhur mes shoqerise dhe ortakut, e cila permban kushte me pak te favorshme per shoqerine, ne krahasim me kushtet normale te tregut
4. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese qe duhet te leshohet sipas ketij neni.

## **Neni 14**



## **PERGJEGJESITE PERSONALE PER SHPERNDARJET E NDALUARA**

Administratoret, te cilet nga pakujdesia leshojne një certifikate te pasakte te aftesise paguese, sipas pikes 2 te nenit 77 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” per gjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.

Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividende, per gjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar certifikata e aftesise paguese, ose kur, pavaresisht leshimit te certifikates, keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paftesise paguese te shoqerise, sipas pikes 1 te nenit 77 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur dijeni per kete gjendje.

### **Neni 15**

## **RIKTHIMI I SHPERNDARJEVE TE NDALUARA**

Padite e shoqerise, siç parashikohet ne nenin 78 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, mund te ngrihen edhe sipas pikes 3 te nenit 10 te ketij ligji.

Parashkrimi i padive nis ne daten kur eshte kryer shperndarja e ndaluar.

### **Neni 16**

## **ANULIMI I KUOTAVE NGA SHOQERIA**

Kuota mund te anulohet ne çdo rast me miratimin e ortakut perkates, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga statuti. Te drejtat e detyrimet, qe i rrjedhin ortakut nga zoterimi i kuotes, shuhen me anulimin e saj.

## **ORGANET E SHOQERISE**

### **Neni 17**

## **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

### **Te drejtat dhe detyrimet**

1. Asambleja e pergjithshme eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:
  - a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
  - ç) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
  - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendor ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
  - dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) perfaqesimin e shoquerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoquerise;
  - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
  - i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e per gjithshme merr vendime per çeshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "e" pas marres dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.

### Neni 18

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME**

1. Asambleja e per gjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara ne ligjin " Per tregtaret dhe shoquerite tregtare", nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoquerise. Mbledhja e asamblese se per gjithshme thirret te pakten nje here ne vit.
2. Asambleja e per gjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoquerite tregtare".
3. Asambleja e per gjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoquerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
4. Asambleja e per gjithshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Asambleja e per gjithshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoquerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
6. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni, asamblese se per gjithshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
7. Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 4 e 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoquerise dhe behen ne kushte normale tregu. Gjithashtu, keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.



8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni, asambleja e per gjithshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

### **Neni 19**

#### **MENYRA E THIRRJES**

1. Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

### **Neni 20**

#### **KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES**

1. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e per gjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut, mund t'i drejtojne administratoreve nje kerke me shkrim, perfshire posten elektronike, per te thirrur asamblene e per gjithshme dhe/ose perfshirjen e çeshtjeve te posaçme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe çeshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim. Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne çeshtjet e rendit te dites, ne perputhje me piken 1 te nenit 83 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"
2. Nese, ne kundershtim me piken 1 te ketij neni, asambleja e per gjithshme nuk thirret, ose çeshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, ka te drejte:
  - a) te ngreje padi ne gjykate, per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese administratori nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve;
  - b) t'i kerkoje shoqerise blerjen e kuotave, te zoteraura prej tyre.
3. Ne rastet kur rendi i dites ndryshohet, sipas parashikimeve te pikave 1 e 2 te ketij neni dhe thirrja i eshte njoftuar ortakeve, administratoret njoftojne perseri rendin e dites, te ndryshuar, ne perputhje me parashikimet e pikes 1 te nenit 83 te ligjit " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
4. Perfaqesuesi i autorizuar eshte i detyruar te deklaroje çdo fakt apo rrethane, te tille qe, sipas gjykit te ortakut te perfaqesuar, rrezikon te ndikoje ne vendimmarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga ata te ortakut te perfaqesuar.

### **Neni 21**

#### **PERFAQESIMI NE ASAMBLE**

1. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.
2. Administratoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues te ortakeve ne asamblene e per gjithshme.
3. Autorizimi jepet ne forme shkresore vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme dhe eshte i vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite

### **Neni 22**

#### **KUORUMI**

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejtë vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
2. Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur ne pikën 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### **Neni 23**

#### **MARRJA E VENDIMEVE**

1. Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te ortakeve pjesemarres, siç percaktohet ne pikën 1 te nenit 86 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, per çeshtjet e tjera te renditura ne nenin 81 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.
3. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj, vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne kete ligj ose ne statut, kushtezohet nga miratimi i ortakut perkates.

### **Neni 24**

#### **E DREJTA E VOTES**

1. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne statut, çdo ortak ka te drejta vote ne perpjersetim me vleren nominale te kuotes se tij. Bashkezoteruesit e nje kuote ushtrojne te drejtat e votes bashkerisht, sipas nenit 72 te ligjit “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”
2. Statuti mund te parashikoje per ortaket, qe nuk jane te pranishem, mundesine e pjesemarrjes ne mbledhjen e asamblese se per gjithshme me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i ortakeve.
3. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:
  - a) transmetimin e mbledhjes se asamblese se per gjithshme ne kohe reale;
  - b) komunikimin e ndersjelle ne kohe reale, i cili u mundeson ortakeve te shprehen per mbledhjen e asamblese se per gjithshme nga nje vendndodhje tjeter;
  - c) mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se per gjithshme, pa qene nevoja te caktohet nje perfaquesues i autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje.
4. Perdorimi i mjetave elektronike, per t'u mundesuar ortakeve te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se per gjithshme, behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per te garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike, deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arrijen e ketyre qellimeve.
5. Ortaket kane te drejtenper te marre unanimisht çdo vendim, me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim.

### **Neni 25**

#### **PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendim per:
  - a) vleresimin e veprimtarise se tij;
  - b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
  - c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
  - ç) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaquesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqueson.

### **Neni 26**

#### **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE**

1. Te gjitha vendimet e asamblese se per gjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal.

Administratoret per gjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se per gjithshme.

2. Procesverbal i duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve, si edhe akti i thirrjes se asamblese se per gjithshme.
4. Procesverbal i mbledhjes nenshkuhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
5. Nese shoqeria ka publikuar një faqe ne internet, administratoret, jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes, jane te detyruar te publikojne kopje te procesverbalit te mbledhjes se asamblese se per gjithshme ne kete faqe.

### **Neni 27**

#### **HETIME TE POSACME**

1. Asambleja e per gjithshme mund te vendose nisjen e një hetimi te posaçem per parregullsitë per gjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare. Hetimi kryhet nga një ekspert i pavarur i fushes.
2. Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo një vlerë me te vogel te parashikuar ne statut dhe/ose cilido kreditor i shoqerise mund t'i kerkojne asamblese se per gjithshme emerimin e një eksperti te pavarur te fushes, kur ka dyshime te bazuara per shkelje te ligjt ose te statutit. Ortaket apo kreditoret e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per emerimin e ekspertit te pavarur, mund t'i kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti. Nese asambleja e per gjithshme nuk merr një vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, kerkesa e ortakeve vleresohet e refuzuar.
3. Kur asambleja e per gjithshme ka emeruar një ekspert te fushes per kryerjen e hetimit te posaçem dhe kur per kete emerim ka dyshime te bazuara per te besuar se eksperti mund te mos realizojet hetimin e posaçem ne menyren e duhur, ortaket ose kreditoret e permendur ne pikën 2 te ketij nenit mund t'i kerkojne gjykates zevendesimin e tij.
4. Kur gjykata pranon kerkesat e permendura ne pikat 2 e 3 te ketij nenit, shoqeria tregtare perballon kostot e emerimit dhe te shperblimit te ekspertit te emeruar per kryerjen e hetimit te posaçem.
5. E drejta per te kerkuar hetim te posaçem, sipas pikave 1 e 2 te ketij nenit, duhet te ushtrohet brenda 3 vjeteve nga data e regjistrimit te shoqerise tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e procesit te themelimit, si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit, qe konsiderohet i parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsitë e ushtrimit te veprimtarise tregtare.

6. Kreditori, qe ne keqbesim paraqet nje kerkese, sipas pikes 2 te ketij nenii, per gjigjet ne perputhje me nenin 34 te Kodit te Procedures Civile.

### Neni 28

#### **SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI**

1. Asambleja e per gjithshme, ne baze te nje vendimi te marre me shumicen e percaktuar sipas pikes 2, neni 87, ligjt “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ka te drejte te ngreje padi perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, si pasoje e shkeljes se rende te ligjt ose te statutit dhe/ose padi te tjera qe parashikon ligji ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.

2. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise ose nje vlere me te vogel, te parashikuar ne statut, dhe/ose kreditoret e shoqerise, te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5 per qind te kapitalit, mund t'i kerkojne asamblese se per gjithshme ngritjen e padise per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve.

Ortaket apo kreditoret e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrene drejtperdrejt, perpara gjykates kompetente, padi ne emer te shoqerise, per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e per gjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve te percaktuar me siper vleresohet e refuzuar.”.

3. Ne rastet kur shoqeria ngriti si me siper, ajo merr pjese ne gjykim me ane te nje perfaqesuesi te posaçem, te caktuar nga asambleja e per gjithshme.

4. Ortaket ose kreditoret e permendur ne piken 2 te ketij neni mund t'i kerkojne gjykates zevendesimin e perfaqesuesit te posaçem, kur ka dyshime te bazuara se perfaqesuesi i emeruar nga asambleja e per gjithshme mund te mos ngrije e ndjeke padine ne interesin me te mire te shoqerise. Nese gjykata e pranon kete kerkesa, kostot e emerimit dhe te shperblimit te perfaqesuesit perballohen nga shoqeria.

5. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmerise se vendimit te administratorit, nese ai nuk merret vesh, me pajtim, me perfaqesuesin e posaçem per korrigimin e pasojave te vendimit, brenda 30 diteve nga data e emerimit te ketij perfaqesuesi. Te drejtat e paleve te treta mbeten te pacenuara, ne perputhje me piken 3 te nenit 12 te te ligjt nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” .

6. Ortaket ne pakice dhe kreditoret e percaktuar me siper kane te drejtat e parashikuara ne pikat 2 e 4 te ketij neni, edhe ne rastin kur asambleja e per gjithshme nuk merr vendim, ose refuzon te vendose per kerkesen e tyre per ngritjen ndaj administratoreve te padise, me objekt shperblimin

e demit te pesuar nga shoqeria, si vendim i paligjshem, apo per ngritjen e padive te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.

7. Dispozita e paragrafit te gjashte te nenit 91 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” zbatohet edhe per keto padi.

#### Neni 29

#### TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga çasti i cenimit.

#### Neni 30

#### ADMINISTRATORI

##### Emerimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet

Administrator i shoqerise **“PETRA TRADING” sh.p.k Tirane emerohet z. Angelo Sciortino** dhe afati i emerimit eshte per nje periudhe 2 vjecare me te drejte riperteritjeje.

1. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit. “Emerimi i administratorit, i cili hyn ne fuqi ne daten e percaktuar sipas aktit te emerimit, u kundrejtohet paleve te treta sipas percaktimeve te nenit 12 te ligjit“ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.”

2. Administratoret e nje shoqerie tregtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

3. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimitarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;

b) perfaqesojne shoqerine tregtare;

c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise; ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimitarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;

d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimitarise dhe ekzistencen e shoqerise;



15

dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Bisnesit;

e) raportojne perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare; e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut

Gjithsesi do te jete i nevojshem autorizimi paraprak i ortakeve me vendim qe do te merret me voten pro te ortakeve qe perfaqsojne te pakten 51 % ( pesedhjete e nje per qind ) te kapitalit te shoqerise per realizimin e ketyre detyrave :

f) marrjen e kredive, garancive dhe hapjen e kredive ne per gjithesi prane cdo instituti ose ndermarrje kredie, me ose pa garanci, te cfaredo vlere ;

g) shitblerjen, kontributet dhe dhenien me qira te ndermarrjeve ose degeve te ndermarrjeve;

gj) themelimin e shoqerive te cdo lloji, konsorciumeve dhe enteve kolektive te cdo lloji;

i) shitjen dhe blerjen e pjesemarrjeve dhe interesave te cdo lloji;

j) blerjen, shitjen dhe dhenien me qira te pasurive te paluajtshme te regjistruara;

4. Ne rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", administratori eshte i detyruar te therrase asamblene e per gjithshme.

5. Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

6. Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Asnje marreveshje tjeter nuk mund te perjashtoje apo kufizoje kete te drejte.

Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

7. Administratori mund te heqe dore ne çdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se per gjithshme. Administratori, qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rr Ethanat e veprimtarise se shoqerise, eshte gjithashtu i detyruar te therrase asamblene e per gjithshme per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.

8. Nese asambleja e per gjithshme nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administratori i dorehequr, atehere administratori i njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Bisnesit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se per gjithshme dhe Qendra Kombetare e Bisnesit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Bisnesit ", te ndryshuar.

9. Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administratori ka ndaj saj, sipas ketij ligji.".

### **Neni 31**

#### **PERFAQESIMI**

1. Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratoreve i kundrejtohen paleve te treta, neperputhje me dispozitat e nenit 12 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.
2. Administratoret, qe perfaqesojne bashkerisht shoqerine tregtare, mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratoreve jane te vlefshme e detyruese per shoqerine.
3. Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

### **NENI 32**

#### **SHPERBLIMI ADMINISTRATORIT**

1. Shperblimit baze te administratoreve mund t'i behen shtesa, qe mund te jene perqindje ne fitim ose te ngjashme. Shperblimet e administratoreve percaktohen me vendim te zakonshem te asamblese se per gjithshme.
2. Shperblimi, sipas pikes 1 te ketij neni, duhet te jetë i pershatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratoreve dhe gjendjen financiare te shoqerise.
3. Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e per gjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratoreve ne masen e pershatshme.
4. Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratoreve ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen se bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **Neni 33**

#### **DETYSRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA**

1. Perveç sa eshte parashikuar ne dispozitat e per gjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”. administratoret detyrohen:
  - a) te kryejne detyrat e tyre ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te veçante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
  - b) te ushtrojne kompetencat vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
  - c) te vleresojne me per gjegjesi çeshtjet, per te cilat merret vendim;



17

- ç) te parandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te garantojne miratimin e marreveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 te nenit 13 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.
- dh) te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratoret, gjate kryerjes se detyrave te tyre, per gjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
3. Nese administratoret veprojne ne kundershtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, jane te detyruar t'i demshperblejne shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojne çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratoret kane barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.
4. Ne menyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratoret jane te detyruar t'i demshperblejne shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ketij ligji, kryejne veprimet e me poshtme:
- a) u kthejne ortakeve kontributet;
  - b) u paguajne ortakeve interesa apo dividende;
  - c) u shperndajne aktivet shoqerise;
  - ç) lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
  - d) jadin kredi.
5. Dispozitat e pikes 6 te nenit 92 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”. zbatohen edhe per padite, qe rrjedhin nga paragrafet e ketij neni. Keto padi duhet te ngrisen brenda 3 vjetave nga kryerja e shkeljes apo nga zbulimi i saj.

#### NENI 34

#### PRISHJA E SHOQERISE, LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

**Shoqeria me per gjegjesi te kufizuar prishet:**

- a) kur mbaron kohe zgjatja, per te cilin eshte themeluar;



- b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
- c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfunkcionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
- ç) ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 i ligjt “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”;
- d) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
- dh) ne raste te tjera, te parashikuara me ligi;
- e) per çdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.

2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ligjt “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara ne shkronjat “a”, “c”, “d”, dhe “dh”, te pikes 1, te ketij neni, çdo person i interesuar mund, ne çdo kohe, t’i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekzistanca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara nga shkronjat “a”, “c”, “d”, “dh” dhe “e”, te pikes 1, te ketij neni, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave te likuidimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, te permendur ne pikën 3, te ketij neni, shkaku i prishjes eshte korriguar, nese eshte e mundshme te korrigohet, dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne regjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjt nr. 9723, date 3.5.2007, “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, te ndryshuar.

5. Prishja e shoqerise, si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen “b”, te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likuiduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendoz rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.

6. Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen “ç”, te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjt “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

**Neni 35**

#### **REGJISTRIMI I SHPERBERJES**

Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Bisnesit, ne perputhje me nenin 43 te ligjt nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit" te ndryshuar .

Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata, ne perputhje me nenin 45 te ligjt nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Bisnesit " ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Bisensit per regjistrim.

### **Neni 36**

#### **LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME**

1. Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.
2. Ortaku qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim, si dhe te parashtroje shkaqet e largimit.
3. Administratoret duhet te therrasin mbledhjen e asamblese se pergjithshme menjehere pasi te kene marre dijeni per njoftimin e largimit, sipas pikes 2 te ketij neni, per te vodosur nese ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.
4. Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likuidimin e kuotes, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme, nese pas njoftimit te largimit asambleja e pergjithshme nuk mblidhet apo nuk i njeh si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotes.
5. Ortaku qe kerkon largimin nga shoqeria, detyrohet ta demshperbleje shoqerine per demet e shkaktuara, nese rezulton se largimi eshte kryer ne baze te shkaqeve te paarsyeshme.
6. Ortaku qe largohet ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe/ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkonte ndaj tyre, ne menyre solidare, shperblimin e demit te pesuar.

### **Neni 37**

#### **PERJASHTIMI I ORTAKUT**

1. Ne baze te nje vendimi te zakonshem, asambleja e pergjithshme mund t'i kerkonte gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.
2. Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut, sipas pikes 1 te ketij neni, por pa u kufizuar ne to, rastet kur ortaku:
  - a) me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere;
  - b) me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj;

- c) perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut; ose
- ç) me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.
3. Gjate procedures se perjashtimit te ortakut, me kerkese te paditesit, gjykata mund te marre nje mase per sigurimin e padise, duke pezulluar te drejten e votes se ortakut, qe kerkohet te perjashtohet, si dhe te drejtat e tjera, qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te justifikuar.
4. Shoqeria ka te drejte t'i kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet, qe kane sjelle perjashtimin.
5. Ortaku ka te drejte t'i kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar, nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.
6. Ortaku nuk ka te drejte t'i kerkoje shoqerise likuidimin e kuotes, nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme, por, nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi, ortaku ka te drejte te kompensoje çdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfiton ne cilesine e likuidimit te kuotes, me demin e kerkuar nga shoqeria.

#### **Neni 38**

#### **PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT**

1. Te gjitha te drejtat, qe rrjedhin nga cilesia e ortakut ne shoqeri, shuhen ne daten e largimit ose te vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjashtimin.
2. Statuti nuk mund te perjashtoje apo te kufizoje te drejten e ortakut per t'u larguar nga shoqeria dhe te drejten e shoqerise per te perjashtuar ortakun.

#### **Neni 39**

#### **LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESESE PAGUESE**

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese,sipas neneve 190 deri ne 205 te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” te ndryshuar.

#### **Neni 40**

#### **MOSMARREVESHJET**

Per çdo mosmarreveshje ndermjet ortakeve, e lindur ne kuadrin ose per shkak te kesaj kontrate, do te behen te gjitha perpjekjet te zgjidhen me mirekuptim, ne rast te kundert çeshtja i paraqitet Gjykates se Tiranes, duke u gjykuar mbi bazen e ligjislacionit shqipetar.

#### **Neni 41**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Per gjithçka qe nuk eshte shprehur ne statutin te kesaj shoqerie do tu referohemi ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" te ndryshuar dhe dispozitave te tjera ligjore ne fuqi.

Ky statut u shkrua, u lexua dhe u firmos me vullnet te lire e ndergjegje te plete nga ortaku themelues i shoqerise " PETRA TRADING " Sh.p.k Tirane sot me date 17.01.2018, ne tre kopje ne gjuhen shqipe.

Ortaku i shoqerise, shtetasi italian z. Angelo Sciortino mori dijeni per permbajtjen e ketij statuti nga perkthimi i bere ne gjuhen italiane nga z.Paqesor Qato.

**ORTAKU I VETEM I SHOQERISE  
"PETRA TRADING " SH.P.K TIRANE**

**ANGELO SCIORTINO**

*Angelo Sciortino*  
*Angelo Sciortino*